



Arjan Lame, PhD

**Drejtues i Qendrës për Studime dhe Kërkime
Ekonomiko-Juridike**

Tirana Business University College

Arjan Lame, PhD është diplomuar nga Universiteti i Triestes (Itali) në Shkencat Politike, Marrëdhënie ndërkombëtare. Teza e *Laurea* së tij ka qenë: "Élita politike dhe e ardhmja e Shqipërisë: një tryezë e rumbullakët me politikanë shqiptarë ". Ai është studiues kërkimor i certifikuar (Ph.D.) nga Universiteti i Triestes, në Marrëdhëniet Ndërkufitare. Titulli i doktoraturës: "Bashkëpunimi ndërkufitar si instrument për parandalimin e konflikteve kufitare: Rasti i Shqipërisë dhe ish-FYROM. Eksperiencën në mësimdhënie e ka inicuar gjatë shkëmbimeve universitare të doktoraturës duke filluar në Eötvös Lorand University (Hungari) dhe Cluj-Napoca (Rumani).

Në lëmin e kërkimit shkencor është aktivizuar duke filluar gjatë studimeve universitare në Institutin e Studimeve të Europës Lindore në Trieste dhe në Institutin e Sociologjisë Ndërkombëtare në Gorizia (Trieste). Është studiues i fenomeneve migratore, politike dhe ndërkufitare shqiptare dhe të zhvillimeve shoqërore politiko-ekonomike dhe të sigurisë në hapësirën ndërkufitare shqiptare dhe të vëndeve të Danubit. Siguria ushqimore dhe veterinaria është një dimension që ka zhvilluar së fundmi pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV). Sustainable and Eco-Tourism është një fushë e hulumtuar në kërkimin shkencor të aplikuar në impaktin e ndërtimit të infrastrukturës së rrugore Shëngjin-Velipojë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Është anëtarë i rrjeteve të BE-së Horizon Europe "Secure Societies" dhe COST Action China in Europe.

Aktualisht ai mban postin e drejtuesit të Qendrës për Studime dhe Kërkime Ekonomike dhe Juridike në Kolegjin Universitar të Biznesit në Tiranë. Midis artikujve shkencorë të prezantuar në konferenca ndërkombëtare që trajtojnë fenomenet e përmendura më sipër, spikat publikimi i një libri: "Kufij dhe Konflikte: Territore të Fenomeneve Konfliktuale, Botimet Fishta, 2017, Tiranë.